



Projekti “Iniciativa për Rritjen e Dialogut Publik  
për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë”



## VLERËSIMI I SITUATËS DHE IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE NË KUADËR TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË NE RAJONIN POGRADEK DHE KORÇË

Mars 2014



KY PROJEKT FINANCOHET  
NGA BASHKIMI EVROPIAN

PROJEKTI ZBATOHET NGA



AKADEMIA E  
STUDIMEVE  
POLITIKE



QENDRA PËR  
KËRKIME DHE  
POLITIKËBËRJE

Akademia e Studimeve Politike (ASP)  
Rr. Donika Kastrioti, Qendra Kotoni,  
Kati 4, Tiranë, Shqipëri  
Tel/fax: 00 355 4 2272173  
Tel: 00 355 44504788  
E-mail : [info@asp.al](mailto:info@asp.al)  
Web: [www.asp.al](http://www.asp.al)

Qendra për Kërkime dhe Politikëbërje (CRPM)  
Rr. Cico Popovik 6-2/9, Shkup, Maqedoni  
Tel: 0038923109-932;  
0038923121-488;  
0038923088-141  
Fax: 0038923073-890  
E-mail: [crpm@crpm.org.mk](mailto:crpm@crpm.org.mk)  
Web: [www.crpm.org.mk](http://www.crpm.org.mk)

Ky program financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Akademia e Studimeve Politike dhe Qendra për Kërkime dhe Politikëbërje. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e zbatuesve të programit nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Evropian.

# Përmbajtja

|                                                        |    |
|--------------------------------------------------------|----|
| 1. Hyrje.....                                          | 3  |
| 2. Vlerësimi i Situatës .....                          | 4  |
| 3. Metodologjia .....                                  | 5  |
| 3.1. Hapat .....                                       | 5  |
| 3.2 Intervistat .....                                  | 6  |
| 3.3 Përzgjedhja e të Intervistuarve .....              | 7  |
| 4. Analiza e Rezultateve Korçë e Pogradec .....        | 9  |
| 5. Rekomandime .....                                   | 15 |
| Aneks 1. Pyetësi, formati dhe metodologjia.....        | 16 |
| Metodologjia e sondazhit .....                         | 16 |
| Modelet e pyetësorëve për bizneset dhe familjarët..... | 17 |

## 1. Hyrje

Ky botim është përgatitur në kuadër të Projektit “Iniciativa për Rritjen e Dialogut Publik për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë” financuar nga Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA BNK 2007-2013 Republika e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë i Bashkimit Evropian.

Organizatat zbatuese të këtij Programi janë Akademia e Studimeve Politike (ASP) në Shqipëri ne partneritet me Bashkinë e Pogradecit dhe Bashkinë e Korçës si dhe Qendra për Kërkime dhe Politikëbërjen (CRPM) në Maqedoni, në bashkëpunim me Bashkitë e Manastirit (Bitola) dhe Kërçovës (Kiçevo).

Projekti synon forcimin e bashkëpunimin mes strukturave të pushtetit vendor

në Shqipëri dhe Maqedoni dhe krijimin e premisave të duhura për ngritjen e një Platforme të Përbashkët Rajonale Veprimi, e aftë për t'u zbatuar edhe nga rajone të tjera. Eksperienca e fituar falë këtij programi, shërbejnë për të nxitur bashkëpunime të tjera ndërkufitare edhe në fusha të tjera si barazia gjinore, të drejtat e minoriteteve etj.

Projekti ka si target:

1. Strukturat vendore të rajoneve Pogradec dhe Korçë në Shqipëri, si dhe Manastirit dhe Kërçovës në Maqedoni
2. Sektorin e biznesit vendor (Biznesi i vogël, hotelieri-turizëm, ndërtim etj)
3. Median – Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimi i gazetarëve do të synojë arritjen tek një publik sa më i madh
4. Shoqërinë civile – organizatat mjedisore dhe aktivistët civilë duhet të ushtrojnë presionin e duhur ndaj vendimmarrësve për të nxitur politika pozitive në këtë drejtim

Përfitues final mbetet publiku i gjerë në këto katër rajone, por edhe në të gjithë Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Autoritetet vendore në katër rajonet e përfshira në këtë projekt po përfitojnë rritjen e mëtejshme të njohurive të stafit të tyre si dhe eksperiencë në organizimin e dialogut publik për shumë çështje të tjera, duke u mbështetur nga kapacitetet e ASP dhe CRPM për të sjellë së bashku drejtues të rëndësishëm lokalë dhe ekspertë profesionistë, aktivistë civilë dhe përfaqësues të medias. Njëkohësisht, komunikimi në të dyja anët e kufirit si dhe shkëmbimi i shembujve më të mirë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta që shqetësojnë qytetarët, ndihmon në kapërcimin e pengesave, të cilat vijnë nga paragjykimet historike etnike, sociale dhe fetare në rajonit e Ballkanit.

Organizatrat, që zbatojnë projektin, ASP dhe CRPM kanë një eksperiencë të gjatë në ndërtimin e këtyre urave të bashkëpunimit shumëplanësh rajonal.

Në këtë kuadër, ASP falënderon bashkëpunimin me Bashkitë Korçë e Pogradec dhe aktorët lokalë për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë këtij procesi.

## 2. Vlerësimi i Situatës

Për të arritur objektivat e vendosura nga Bashkimi Evropian në fushën e energjisë, zotime të cilat kanë marrë përsipër edhe vendet tona si aspirante për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, duhet të punojnë së bashku të gjithë sektorët e shoqërisë, jo vetëm insitucionet publike dhe legjislative, por edhe shoqëria civile, bizneset private, mediat dhe secili qytetar.

Ky projekt ndërkufitar synon që të nxisë bashkëpunimin e mëtejshëm mes rajoneve të Shqipërisë dhe Maqedonisë, duke nxitur zbatimin e politikave të përbashkëta për shpejtimin e progresit drejt integritit të plotë të rajonit në Bashkimit Evropian.

Shqipëria dhe Maqedonia kanë nisur rrugën e tyre të integritit në Bashkimin

Evropian. Për të qënë pjesë e këtij organizimi të rëndësishëm, është i nevojshëm përcaktimi i standarteve evropiane në fushën sociale, ekonomike, duke përfshirë edhe energjinë dhe mjedisin. Në përputhje me Direktivat Europiane dhe paketën e udhëzimeve për energjinë dhe mbrojtjen e mjedisit, të dyja vendet janë zotuar për arritjen e objektivave ambiciozë “20:20:20”, ose ndryshe rritja e eficiencës së energjisë me 20%; rritja me 20 % e përdorimit të energjive të rinovueshme dhe ulja me 20 % e emisioneve të dioksidit të karbonit deri në vitin 2020.

Ndërsa të dyja vendet janë duke shënuar një progres të kënaqshëm për adaptimin e legjislacionit evropian në legjislacionin vendas, vihet re një stanjacion në zbatimin praktik të këtyre politikave dhe rregulloreve. Gjithashtu, ka një sensibilizim të ulët dhe dëshirë minimale për të vënë në veprim masat e duhura në lidhje me çështjen e përdorimit të qëndrueshëm të energjisë.

Për këtë arsye, është i nevojshëm që të nxitet bashkëpunimi i institucioneve qendrore dhe vendore, por edhe përfshirja e biznesit, shoqërisë civile dhe çdo aktori tjetër të rëndësishëm në mënyrë që të arrihet ndërgjegjësimi i duhur mbi standartet e prodhimit dhe përdorimit të energjisë në të dyja anët e kufirit.

Në këtë mënyrë, të dyja vendet tona do të bëjnë një hap të mëtejshëm drejt Bashkimit Evropian.

Me qëllim që projekti të krijojë premisat e duhura për ngritjen e një Platforme të Përbashkët Rajonale Veprimi, e aftë për t’u zbatuar edhe nga rajone të tjera, e për të kuptuar situatën reale duke bërë një fotografim sa më të plotë të situatës është hartuar një Vlerësim Nevojash në Bashkinë Pogradec dhe Korçë duke marrë një konsultim të drejtpërdrejtë e të gjithë me të gjithë aktorët e këtyre bashkive.

## 3. Metodologjia

### 3.1. Hapat

Me qëllim arritjen e synimeve për të patur një fotografim sa më të saktë të situatës u ndoqën hapat e mëposhtme:

- U studiuan zhvillimet e deritanishme e tendencat strategjike në fushën e eficiencës dhe kuadri ligjor.
- Në bashkëpunim me partnerët Maqedonas, u diskutua rreth elementëve të pyetësorëve e intervistave.
- U përgatiten draft pyetësorët në ndihmë të intervistuesve për kategorinë Familjarë dhe Biznese.
- U përgatit draft metodologjia e zgjedhjes së grupit përfaqësues të të intervistuarve për dy kategoritë.
- U zhvillua një proces konsultimi me të interesuarit kryesorë dhe partnerët në projekt.
- U finalizua Pyetësori në ndihmë të intervistuesve për kategorinë Familjar dhe Biznes.



- U finalizua metodologjia për identifikimin dhe intervistimin e grupeve përfaqësuese.
- U finalizua Baza e të dhënave në EXEL për hedhjen e rezultateve të intervistave.
- Materialet e përgatitura iu dërguan organizatave të shoqërisë civile të përzgjedhura duke i shoqëruar me shpjegime dhe sqarime dhe iu krijua mundësia për sqarime të mëtejshme nëse do kishin nevojë.
- Gjatë periudhës së kryerjes dhe hedhjes së të dhënave të intervistimeve u mblodhën të dhëna të përgjithshme që do t'i shërbenin procesit të analizimit të rezultateve.
- Me përfundimin e procesit të intervistimit dhe hedhjes së të dhënave filloi procesi i përpunimit.
- U përgatiten rezultatet e intervistave në formë grafike e tabelare për Korçën dhe Pogradecin.
- U bë krahasimi i rezultateve sipas kategorive Familjar/Biznes dhe Korçë/Pogradec.
- U analizuan gjetjet për çdo rajon dhe si mesatare e përgjithshme pasi rezultatet ishin të përafërta.
- Analiza u krye dhe u paraqit sipas sipas atyre çështjeve që ishin paracaktuar në metodologji.
- U përgatit një material në Poëer Point për prezantim në takimin e përbashkët midis aktorëve lokalë të Korçës e Pogradecit cili u diskutua në këtë takim interaktiv duke tentuar një proces paraprak "brain storming".
- U evidentua qëndrimi i të interesuarve kryesorë pjesëmarrës në takim.

## 3.2 Intervistat

*3.2.1 Në çdo qytet u realizuan 300 intervista ( 200-Familjarë dhe 100-biznese) për të analizuar si vijon:*

### **Për konsumatorët familjarë**

1. Konsumi dhe efekti i pritshëm me aplikimin e përdorimit eficient të energjisë.
2. Nevojave të Informimit të publikut lidhur me eficiencën e energjisë.
3. Gadishmërisë së publikut për të investuar në drejtim të përdorimit eficient të energjisë.
4. Grupimit të konsumatorëve sipas mundësisë për përdorimin eficient të energjisë.
5. Efektet në përmirësimin e konstruktit të banesave

6. Efektet në përmirësimin e ngrohjes/ftohjes së ajrit në banesa
7. Efektet në ndricim të banesave
8. Efektet në pajisjet e ngrohjes së ujit në banesa
9. Efektet në pajisjet e gatimit
10. Efektet në përdorimin e pajisjeve elektronike
11. Propozime lidhur me aplikimin e përdorimit eficient të energjisë.

### **Për Konsumatorët në Bizneset e turizmit dhe hotelerisë**

1. Konsumi dhe efekti i pritshëm me aplikimin e përdorimit eficient të energjisë.
2. Nevojave të Informimit lidhur me eficientësinë e energjisë.
3. Gadishmërisë për të investuar në drejtim të përdorimit eficient të energjisë.
4. Grupimit sipas mundësisë që kanë për përdorimin eficient të energjisë.
5. Efektet në përmirësimin e konstruktit të ndërtesave
6. Efektet në përmirësimin e ngrohjes/ftohjes së ajrit në ambjentet e biznesit
7. Efektet në ndricim të ambjenteve të biznesit
8. Efektet në pajisjet e ngrohjes së ujit në ambjentet e biznesit
9. Efektet në pajisjet e gatimit
10. Efektet në përdorimin e pajisjeve elektronike
11. Propozime lidhur me aplikimin e përdorimit eficient të energjisë.

## **3.3 Përzgjedhja e të Intervistuarve**

### ***3.3.1 Intervistat për konsumatorët familjarë.***

- 50 intervista në sportelet ku paguhet energjia elektrike (50/numri i sporteleve)
- 50 intervista me mësues në shkollat e qytetit (50/Numri i shkollave)
- 50 intervista në institucionet qendrore e vendore (50/numri i institucioneve)
- 50 intervista në sportelet ku ndahen pensionet apo posta (50/numri i sporteleve)

### *3.3.2 Intervistat për bizneset*

- 30 intervista në hotelet e qytetit
- 30 intervista në bizneset e shërbimeve (bar, restorante)
- 40 intervista të bizneset e tregtimit me pakicë.

### *3.3.3 Kriteret në përzgjedhjen e të intervistuarve*

- Shpërndarja e barabartë e të intervistuarve nga pikpamja e shpërndarjes territoriale në gjithë territorin.
- Ruajtja sa më shumë e raportit 50/50 ndërmjet të intervistuarve femra/meshkuj
- Raporti 70/30 ndërmjet të intervistuarve kryefamiljarë/jokryefamiljarë
- Raporti 60% i moshës 30-50 vjec e 40% e moshës 50-70 vjec
- Raporti 60/40 ndërmjet të intervistuarve me arsim të lartë/me arsim të mesëm.
- Raporti 40/60 ndërmjet të intervistuarve me përbërje familjare 3 dhe 4 persona në familje
- Raporti 60/40 i të intervistuarve me të ardhura nën/mbi mesataren.



## 4. Analiza e Rezultateve Korçë e Pogradec

| Te dhena te peraferta per perdorimin e energjise elektrike | Zona Korçe |         |       |          |
|------------------------------------------------------------|------------|---------|-------|----------|
|                                                            | Bilishi    | Kolonje | Korçe | Pogradec |
| Konsumi GWh/mt                                             | 74         | 30      | 400   | 170      |
| Pesha Specifike ne konsumin e vendit                       | 0.54       | 0.22    | 2.91  | 1.24     |
| Total Humbje                                               | 36.5%      | 23.6%   | 39.7% | 33.9%    |
| Total Arketime                                             | 87%        | 97%     | 92%   | 82%      |
| Efektiviteti i shitjes                                     | 56%        | 74%     | 56%   | 54%      |

| STRUKTURA E KONSUMIT MESATAR                  |                         |                 |     |               |
|-----------------------------------------------|-------------------------|-----------------|-----|---------------|
| KONSUMI MESATAR FAMILJAR ME LENDE ENERGJITIKE |                         |                 |     |               |
|                                               |                         | Konsumi Mesatar |     | % Perdoruesve |
| Energji Elektrike                             |                         | KWh             | 329 | 100           |
|                                               | Per Ndricimin           | KWh             | 82  |               |
|                                               | Per Ngrohje/Ftohje Ajri | KWh             | 99  |               |
|                                               | Per Ngrohje Uji         | KWh             | 66  |               |
|                                               | Per Pajisje te ndryshme | KWh             | 82  |               |
| Karburant transporti                          |                         | litra           | 46  | 17            |
| Gaz i Lenget                                  |                         | litra           | 8   | 59            |
| Dru Zjarri                                    |                         | m3              | 1   | 88            |

| KONSUMI MESATAR I BIZNESEVE ME LENDE ENERGJITIKE |                         |                 |     |               |
|--------------------------------------------------|-------------------------|-----------------|-----|---------------|
|                                                  |                         | Konsumi Mesatar |     | % Perdoruesve |
| Energji Elektrike                                |                         | KWh             | 354 | 100           |
|                                                  | Per Ndricimin           | KWh             | 90  |               |
|                                                  | Per Ngrohje/Ftohje Ajri | KWh             | 100 |               |
|                                                  | Per Ngrohje Uji         | KWh             | 70  |               |
|                                                  | Per Pajisje te ndryshme | KWh             | 94  |               |
| Karburant transporti                             |                         | litra           | 159 | 8             |
| Gaz i Lenget                                     |                         | litra           | 66  | 22            |
| Dru Zjarri                                       |                         | m3              | 4   | 17            |

### Në Shqipëri në fushën e Eficiencës së Përdorimit të Energjisë, evidentohet një situatë e tillë:


- Zbatimi jo i plotë i ligjit ekzistues për Eficiencën e Energjisë;
- Mungesa e krijimit të Fondit të Eficiencës së Energjisë;
- Mungesa zbatimit të Kodit Energjetik të Ndërtesave në fushë të gjerë;
- Mungesa e një legjislacioni sekondar dhe rregullator për kryerjen e monitorimeve dhe auditimeve energjetike për konsumatorët e mesëm dhe të mëdhenj, si dhe mungesa e sistemit të çertifikimit për audituesit e energjisë;

| Masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë të planifikuara për arritjen e objektivave | Kursimet vjetore të energjisë të parashikuara ne 2018 (ktoe) |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| Paketa e masave në sektorin e banesave                                                      | 37                                                           |
| Paketa e masave në sektorin e shërbimeve                                                    | 32                                                           |
| Paketa e masave në industri                                                                 | 42                                                           |
| Paketa e masave në sektorin e transportit                                                   | 52                                                           |
| Paketa e masave në bujqësi                                                                  | 5                                                            |
| Direktiva e Shërbimeve të Energjisë (ESD) për kursimet totale të energjisë të parashikuara: | 168                                                          |

|                         |   |             |        |
|-------------------------|---|-------------|--------|
| 1 kwh energji elektrike | = | 8.5968 ktoe | (E-08) |
|-------------------------|---|-------------|--------|

- Mungesa e procedurave të përshtatshme ligjore për prokurimin e pajisjeve eficiente;


Targetet e vendosura nga aktorët kryesorë në Shqipëri për zhvillimet në fushën e Eficiencës së përdorimit të energjisë deri në vitin 2018 përshkruhen si më poshtë sipas sektorëve duke shprehur sasinë e parashikuar vjetore të kursimit në KTOE




Përzgjedhja e të intervistuarve plotëson mjaftueshëm kriteret e paravendosura duke krijuar një grupim përfaqësues (sample).

Shprehja e gjendjes dhe konsideratave të këtij grupimi besojmë se i afrohet në mënyrë të konsiderueshme realitetit të përgjithshëm.

Theksojmë se përzgjedhjen e të intervistuarve është shmangur marrja e mendimit nga personat që abuzojnë me sigurimin e energjisë. (kryesisht energjisë elektrike)



- Rreth 35% e konsumatoreve deklarojnë moskuptim të termit “Eficiencë”
- Shpenzimi i përafërt mesatar mujor për energji elektrike është rreth 3 500 lekë/muaj ose rreth 15% të të ardhurave mesatare mujore.
- Ndryshimi ndërmjet konsumit të energjisë elektrike në dimër/verë është rreth 50 KWh/muaj.
- Sipërfaqja e ambjenteve që ngrohet/ftohet është afërsisht 30 m<sup>2</sup> –Familjar 250 m<sup>2</sup> –Bizneset.
- Mbi 80 % të ndërtesave të banimit kanë një vjetërsi mbi 10 vjet.
- Shpenzimi për karburant është ai i madhi (për ato familje që disponojnë automjete).




Konsumi i energjisë elektrike vetëm në muajin Gusht arrin vlerat e konsumit të muajve të dimrit.


Konsumi i gazit të lëngët është afërsisht konstant gjatë vitit duke konfirmuar përdorimin kryesisht për gatim të tij nga rreth 60 % e konsumatorëve familjarë e 33% e bizneseve.

Edhe konsumi i karburantit për automjetet mbetet afërsisht konstant

Konsumi i druve të zjarrit është prezent për periudhën tetor-prill kryesisht për ngrohje.







#### BIZNESET






Shumica e të intervistuarve familjarë dhe biznesmenë mendojnë se duhet të investohet fillimisht në drejtim të izolimit tek dyert dhe dritaret e më pas tek fasada, dyshemeja e tavanet e banesave apo ndërtesave të bizneseve.

Rreth 40 % e të intervistuarve deklarojnë se nuk kanë informacionin e mjaftueshëm në drejtim të teknikave që mund të përdoren dhe mënyrën e vlerësimit të efikasitetit apo kursimit .




- Çdo konsumator përdor mesatarisht rreth 10 llampa ndricimi
- Tek Familjarët mbizotëron përdorimi i llampave inkandeshente ndërsa te bizneset mbizotëron përdorimi i llampave ekonomike
- Rreth 45% e konsumatorëve si familjare, ashtu edhe biznesmene ndjehet nevoja për informacion lidhur me realizimin e ndricimit me mënyra eficiente.
- Konsumi i energjisë për ndricim zë rreth 25 % të konsumit mujor të energjisë elektrike .




- Sobat me dru përdoren gjerësisht për ngrohje në zonën Korçë –Pogradec (90 % të familjarëve)
- Përdorimi i kondicionerëve nga familjarët është rreth 11 %.
- Tek bizneset ngrohe/ftohja realizohet në pjesën më të madhe nga kondi-

cionerët të cilët konsumojnë rreth 20% të konsumit mujor të energjisë elektrike.

- Mbi 40 % e të gjithë konsumatorëve kanë nevojë për informacion lidhur me detajet e efijencës së përdorimit të pajisjeve të ngrohje/ftohjes së ambienteve.




- Boilerët mbizotërojnë në përdorim për ngrohjen e ujit sanitar.
- Konsumi i energjisë për ngrohjen e ujit zë rreth 12 % të konsumit mujor.
- Rreth 40 % kanë nevojë për informacion lidhur me efijencën e përdorimit dhe kostot.





- Televizoret dhe frigoriferët përdoren nga 100% e konsumatorëve e në disa raste me nga më shumë se një pajisje.
- 70% e këtyre pajisjeve të familjarët deklarohen se janë të certifikuara "A" kurse tek bizneset kjo shifër deklarohet të jetë rreth 45%.
- Konsumi mujor i pajisjeve mendohet të jetë rreth 12 % e konsumit mujor familjar të energjisë elektrike dhe 15% e konsumit mujor të bizneseve.
- Rreth 45 % e konsumatorëve ndjejnë se kanë nevojë për informacion më të detajuar.





- Rreth 75 % e konsumatorëve të intervistuar shprehin gadishmërinë për të investuar në drejtim të uljes së nivelit të konsumit të energjisë.
- 85% e të intervistuarve janë të ndërgjegjshëm se përdorimi eficient i energjisë sjell përfitime të konsiderueshme për ta dhe se kjo ndikon pozitivisht edhe në ekonominë e vendit.



Ashtu sic shihet edhe në grafikët e mësipërm, të intervistuarit mendojnë se Akto­rët Kryesorë që mund të ndikojnë në përdorimin eficient të energjisë renditen si më poshtë:

1. Qeverisja Qëndrore e institucionet e saj,
2. Qeverisja Vendore,
3. CEZ-Shpërndarje,
4. Shoqëri Civile,
5. Bankat, Doganat, etj.

Veprimet që këta aktorë mund të kryejnë renditen si më poshtë:

Informim,

Ndërgjegjësim,



Përmirësim i kuadrit ligjor,

Aplikim politikash e projektsh të integruara që mbështesin eficiency si dhe mundësim kreditimi për përdorimin eficient të energjisë.

## 5. Rekomandime

- Duke u nisur nga objektivat e projektit, gjendja aktuale dhe në përputhje me targeted e vendosura kombëtare e rajonale, kërkohet të planifikohen veprime të integruara e të kombinuara.
- Fillimisht rekomandojmë që të organizohet puna për krijimin e një njësie që do të menaxhojë procesin e përgatitjes së platformave dhe planeve të veprimit të çdo njësie vendore të përfshirë në projekt.
- Të miratohen bashkërisht modalitetet e komunikimit dhe të përcaktohen personat e kontaktit.
- Të ndërtohet një metodologji për mënyrën se si do të veprohet për ndërtimin e Platformave ku dallohen veprimet e përbashkëta dhe ato specifike për çdo njësi vendore.
- PLANIFIKIM I VEPRIMEVE TE KRYHET BAZUAR NE GJETJET,OBJEKTIVAT STRATEGJIKE , EKSPERIENCAT ETJ

| QEL-LIMI | OBJEKTIVAT | PROGRAMET | AKTIVITETET | INST/ORG. PERG-JEGJESE | KOSTOT | AFA-TET | PRITSHMER-ITE |
|----------|------------|-----------|-------------|------------------------|--------|---------|---------------|
|          |            |           |             |                        |        |         |               |

- Për çdo aktivitet të planifikuar të ndërtohet një tabelë e ngjashme me ato të Strategjisë Kombetare.
- Te percaktohen idikatoret per matjen e performances (cilesore e sasiore)
- (Mund te shfrytezoni eksperiencat e kosoves)
- Procesi kerkon trajnime dhe informacionet per ceshtjet e meposhtme:
  - Kuadri ligjor , strategjite, detyrimet
  - Efektiviteti dhe perfitimet nga investimet ne izolimi n e ambjenteve
  - Efektiviteti dhe perfitimet nga investimet ne ndricimin e ambjenteve
  - Efektiviteti dhe perfitimet nga investimet ne pajisjet per ngrohje te ambjenteve
  - Efektiviteti dhe perfitimet nga investimet ne pajisjet per ngrohjen e ujit
  - Efektiviteti dhe perfitimet nga investimet ne pajisjet e ndryshme
  - Si te perzgjedhim pajisje eficiente duke llogaritur paraprakisht nevojat.

- Rekomandohet që të përgatiten publikime për çështjet e mësipërme duke përdorur një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për publikun e gjerë, të interesuar për përfshirjen në iniciativat për kursim nëpërmjet përdorimit eficient të energjisë.

Ky projekt konsiderohet i rëndësishëm pasi procesi dhe produktet e tij do të mund të përdoren nga njësitë e tjera dhe do të shërbejnë për ta nxjerrë procesin e planifikuar strategjikisht në rang kombëtar nga situata aktuale.

## Aneks 1. Pyetësi, formati dhe metodologjia

### Metodologjia e sondazhit

Në çdo rajon (Korçë, Pogradec) u realizuan 300 pyetesore (**200-Familjare dhe 100-biznese të vogla**)

#### **Intervistat për konsumatorët familjarë (200 persona)**

- 50 intervista u realizuan ne sportelet ku paguhet energjia elektrike (50/numri I sporteleve)
- 50 intervista u realizuan me mesues ne shkollat e qytetit (50/Numri I shkollave)
- 50 intervista u realizuan ne institucionet qendrore e vendore (50/numri I institucioneve)
- 50 intervista u realizuan ne sportelet ku ndahen pensionet apo posta (50/numri sporteleve)

#### **Kritere që u morën parasysh në përzgjedhjen e të intervistuarve**

- Shpërndarja e barabartë e të intervistuarve nga pikpamja e shpërndarjes territoriale ne gjithë territorin.
- Te ruhet sa me shume raporti 50/50 ndermjet te intervistuarve femra/meshkuj
- Te tentohet drejt raportit 70/30 ndermjet te intervistuarve kryefamiljare /jokryefamiljare
- Te tentohet raporti 60% te moshes 30-50 vjec e 40% te moshes 50-70 vjec
- Te tentohet raporti 60/40 ndermjet te intervistuarve me aresim te larte/me arsim te mesem.
- Te tentohet raporti 40/60 ndermjet te intervistuarve me perberje familjare 3 dhe 4 persona ne familje
- Te tentohet raporti 60/40 i te intervistuarve me te ardhura nen/mbi mesataren.

#### **Intervista për konsumatorët biznese të vogla (100 biznese)**

Në këtë sektor u përshinë bizneset e vogla konsumatore energjie si më poshtë :

- 50 biznese tregtare (Dyqane tregtie dhe shërbimesh)
- 30 Bar/restorante
- 20 Hotele

# Modelet e pyetësorëve për bizneset dhe familjarët



## PYETËSOR

I nderuar biznesmen!

“Akademia e Studimeve Politike”, në kuadër të projektit “Inisiativa për të fuqizuar dialogun publik për përdorimin e qëndrueshëm të energjisë”, të financuar nga Bashkimi Europian, nëpërmjet këtij pyetësi synon të mbledhë informacion mbi përdorimin e energjisë me qëllim që periodikisht të identifikohen prioritetet dhe të merren masa për përdorimin sa më eficient të energjisë.

Ju lutemi shprehni në mënyrë të sqartë dhe me përgjegjësi qytetare qëndrimin tuaj !

“Ju sigurojme se përgjigjet tuaja vetëm do analizohen e nuk do të përdoren në mënyrë personale”

## A. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË TË INTERVISTUARIT

| 1. I Intervistuari është PERFAQESUES I BIZNESIT: |               |          |          |
|--------------------------------------------------|---------------|----------|----------|
| HOTELERI                                         | BAR-RESTORANT | TREGETIM | SHERBIME |
|                                                  |               |          |          |

| 2. I INTERVISTUARI |          | 3. GRUP MOSHA (vjeç) |       |       |       |        | 4. NUMRI PESONAVE TE PUNESUAR |   |   |   |          |     |
|--------------------|----------|----------------------|-------|-------|-------|--------|-------------------------------|---|---|---|----------|-----|
| FEMER              | MASHKULL | 18-24                | 25-34 | 35-49 | 50-64 | mbi 64 | 1                             | 2 | 3 | 4 | 5 e lart | SA? |
|                    |          |                      |       |       |       |        |                               |   |   |   |          |     |

| 5. KU ESHTË VENDNDODHJA E OBJEKTIT TE BIZNESIT<br>(Ndarja administrative e Bashkise) |      |      |      | 6. ARESIMIMI |         |
|--------------------------------------------------------------------------------------|------|------|------|--------------|---------|
| 1( )                                                                                 | 2( ) | 3( ) | 4( ) | Jo i Larte   | I Larte |
|                                                                                      |      |      |      |              |         |

| 7. KONSUMI MESATAR MUJOR I ENERGJISE PER BIZNESIN |                      |                         |                                 |        |
|---------------------------------------------------|----------------------|-------------------------|---------------------------------|--------|
| Dru zjarri (m3)                                   | Gaz i lenget (litra) | Energji Elektrike (KWh) | Nafte/benzine transport (litra) | tjetër |
|                                                   |                      |                         |                                 |        |

| 8. SHPENZIMI MESATAR I PERAFERT MUJOR PER ENERGJINE NE LEKE |                   |                       |                             |        |
|-------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------|-----------------------------|--------|
| Per dru zjarri                                              | Per Gaz te lenget | Per Energji Elektrike | Per Nafte/benzine transport | tjetër |
|                                                             |                   |                       |                             |        |

| 9. A MUND TE SHPREHNI AFERSISHT SASINE E BURIMEVE ENERGJITIKE TE KONSUMUAR GJATE VITIT 2013 |       |       |        |      |       |     |         |        |       |         |       |      |         |      |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------|--------|------|-------|-----|---------|--------|-------|---------|-------|------|---------|------|
|                                                                                             |       | janar | shkurt | mars | prill | maj | qershor | korrik | gusht | shtator | tetor | ntor | dhjetor | 2013 |
| Energji Elekt                                                                               | KWh   |       |        |      |       |     |         |        |       |         |       |      |         |      |
| Diesel                                                                                      | Liter |       |        |      |       |     |         |        |       |         |       |      |         |      |
| Gaz i Lenget                                                                                | Kg    |       |        |      |       |     |         |        |       |         |       |      |         |      |
| Dru Zjarri                                                                                  | m3    |       |        |      |       |     |         |        |       |         |       |      |         |      |

| 10.TE DHENA PER NDERTESEN |                         |                                                             |                                           |                                    |                                    |
|---------------------------|-------------------------|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|
